



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501380/7

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme me qëllim marrjen e kallëzimit shtetasit M.Gj. dhe referimin e tij në organin e Prokurorisë.*

Drejtuar : Shefit të Komisarariatit të Policisë
Z. Besim SAKAJANI

Sarandë

Për dijëni : Drejtorit të Policisë së Qarkut
Z. Joeld ÇELA

Vlorë

I nderuar zoti Sakajani,

Me shkresën nr. K2/D22-2 Prot., datë 14.09.2015, ju kemi vënë në dijeni se, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi M.Gj. me banim në Shkallë, Borsh, Sarandë. Ankuesi shkruan se, në vitin 2011 ia ka lënë në ruajtje me prokurë banesën e tij shtetasit P.M.. Në vitin 2014 ai ka bërë revokimin e prokurës dhe i ka kërkuar shtetasit P.M. që të lirojë banesën. Sipas ankuesit, pasi ai i ka kërkuar shtetasit P.M. të lirojë banesën, P. ia ka dëmtuar rëndë atë dhe aktualisht aty nuk banon njeri. Për shkatërrimin dhe dëmtimin e pronës është bërë akti i ekspertimit dhe së bashku me kallëzimin ankuesi ia ka dorëzuar atë oficerit të policisë gjyqësore Namik Gumeni. Ankuesi pretendon se, kallëzimi i tij, të cilin e ka bërë në datën 24.01.2015 dhe akti i ekspertimit, nuk janë administruar konform ligjit nga oficeri i policisë gjyqësore, sepse nuk i ka dorëzuar ato në komisarariat dhe ndërkohë nuk është bërë referimi i veprës penale në organin e Prokurorisë Sarandë.

Për sa më sipër, ju kërkuam shpjegime lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi për mosadministrimin e kallëzimit të tij nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe mosreferimin e veprës penale në organin e Prokurorisë Sarandë.

Me shkresën nr. 2976/1 Prot., datë 14.10.2015, ju na informuat se nga verifikimet e bëra në Sekretarinë e Komisarariatit të Policisë Sarandë nuk është

gjetur shkresë përciellëse për në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë që bën fjalë për këtë ngjarje.

Ndonëse përgjigjen e kërkuar nga ana jonë na e dërguat me vonesë dhe tej afatit ligjor, nga përmbajtja e saj konstatojmë se pretendimet e ankuesit se, kallëzimi i tij i bërë në datën 24.01.2015 dhe akti i ekspertimit nuk janë administruar konform ligjit nga oficeri i policisë gjyqësore dhe ndërkohë nuk është bërë referimi i veprës penale në organin e Prokurorisë Sarandë.

Gjithashtu me keqardhje konstatojmë se, nga nga juaj nuk rezulton që të jetë vlerësuar shqetësimi i ankuesit M.Gj., sepse nuk keni bërë verifikimet e nevojshme lidhur me pretendimet e ngritura prej tij. Ju kujtojmë se pretendimet e ankuesit bëjnë fjalë për një ngjarje të rëndë të kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Namik Gumeni, dhe konkretisht moskryerje të detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 17/1/i të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe nenet 30, 280, 283, 293 dhe 303 të Kodit të Procedurës Penale, për marrjen, administrimin dhe referimin e veprës penale në organin e Prokurorisë.

Meqënëse nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Sarandë nuk është administruar kallëzimi në fjalë, nga ana juaj, si titullar i këtij komisarati, duhet të bëheshin pa vonesë disa verifikime lidhur me këtë rast, si të thirrej oficeri i policisë gjyqësore Namik Gumeni dhe të pyetej rreth pretendimeve të ankuesit, të thirrej e dëgjohej ankuesi, të thirrej e pyetej eksperti i cili ka bërë aktin e ekspertimit, nëse e ka bërë ose jo atë, kush ia ngarkoi këtë detyrë dhe kujt ia dorëzoi ai aktin e ekspertimit, të bëheshin verifikime në vend rreth pretendimeve të ankuesit për shkatërrimin e banesës së tij nga shtetasi P.M., si dhe veprime të tjera që do të diktoheshin nga veprimet e përshkruara më sipër dhe informacionet e përfutur prej tyre.

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen e të drejtës së ankuesit dhe parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, respektivisht në shkronjën “b” ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”* dhe në shkronjën “d” ku parashikohet se: *“për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre”*,

REKOMANDOJMË

1. Marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme me qëllim marrjen e kallëzimit shtetasit M.Gj. dhe referimin e tij në organin e Prokurorisë.

2. Analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës.

3. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Vlorë me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI